



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 08/11

Prishtinë, më 08.04.2011, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Munguan: Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Edi Shukriu dhe Jeton Rukolli-KKTK, Daut Demaku, Armend Bilalli-KPM, Ismet Krasniqi dhe Istret Azemi nga Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit financiar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për periudhën mars 2009 dhjetor 2010;**
E ftuar: Edi Shukriu, Kryetare e KKTK-së;
- 3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2010;**
I ftuar: Daut Demaku, Nënkryetar i Këshillit të KPM-së;
- 4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2010;**
I ftuar: Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit;
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi që në të ndryshme të shqyrtohet draf-plani i punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2011.

Rendi ditës miratohet me ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2010

Kryetarja, sa i përket raportit të shpenzimeve buxhetore, të dhënat e prezantuar janë pasqyruar shumë i shkurtër, është dashur që shpenzimet në kategoritë e caktuara të jenë më të detalizuara dhe të bëhen krahasimet me rishikimin e buxhetit.

Edi Shukriu, premtoi se do ta sjellin raportin në mënyrë më të detalizuara. Ajo informoi që me buxhetin e rishikimit të vitin 2009 janë ndarë mjetet për vetura, por për shkak të një letre të ish Ministrit gjitha procedurat janë vonuar dhe sot e kësaj dite ende nuk janë blerë veturat. Një prej detyrave të këtij Këshilli është që të bëhet plani nacional për trashëgiminë kulturore të cilin nuk e kemi, duhet të bëhet plani nacional i restaurimit, duhet të bëhet plani nacional për arkeologji, mirëpo për realizmin të gjitha këtyre duhen mjete dhe ekspertë.

Sali Asllanaj, për çështjen e veturave, rikujtojë se me rastin e shqyrtimit të kërkesës buxhetore të Këshillit për 2011, e ka marrë përsipër ta zgjedhë Drejtori i Buxhetit i MF-it, dhe po shihet që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim sado që ka kaluar gati një muaj. KKTK-ja ka nevojë për një mbështetje më të madhe, sepse institucionet që merren me trashëgimi kulturore kryejnë punë shpirtërore. Sugjeroi që duhet të gjenden forma të bashkëpunimit edhe me institucionet tjera, por në të njëjtën kohë duhet bërë përpjekje që të gjejmë edhe përkrahje materiale për t'i mundësuar këtij Këshilli t'i realizojë aktivitetet e tij, sepse në kohë të krizave më së shumti pësojnë institucionet kulturore.

Hykmete Bajrami, theksoi që këto pak të dhëna që janë për buxhetin po del që ju keni shpenzuar më tepër se sa që keni pasur në dispozicion. Lidhur me këtë pyeti se prej nga po del ky suficit, apo është i ndonjë viti më herët që keni pasur?

Jeton Rukolli, sa i përket vitit 2010 buxheti në fillim ka qenë 141 mijë €, ndërsa në rishikim në bazë të kërkesave tona, buxheti është shtuar për 156 mijë e 963, ku prej tyre 15.000 € kanë qenë për qira dhe 2.690 € për shpenzime komunale.

Hykmete Bajrami, sugjeroi që duhet të raportohet i gjithë buxheti që është në dispozicion, sepse edhe mjetet e rishikimit janë mjete që kanë ardhur nga buxheti i Kosovës.

Kryetarja, kërkoi nga Këshilli që të dërgojë një raport më të detalizuara, sidomos për mallra dhe shërbime, si dhe të paraqitet pjesa e mjeteve ashtu si duhet, e jo të paraqiten mjete që janë ndarë me rishikim, sepse nuk është mirë që ky raport të shkojë në këtë mënyrë në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për periudhën mars 2009-dhjetor 2010.
- II. Obligohet KKTK-ja, të dërgojë një raport më të detalizuara financiar për shpenzimet e buxhetit për periudhën e lartpërmendur, që do të jetë pjesë e rekomandimit të Komisionit.

3. Shqyrtimi i raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2010

Kryetarja, theksoi se që raporti është i detalizuar, dhe i përgatitur në përputhje me standartet e kontabilitetit për raportim. Janë pasqyruar të dhënat nëpër kategoritë e caktuara dhe janë bërë krahasimet me vitin e kaluar.

Daut Demaku, njoftoi se buxheti është shpenzuar 95%, afërsisht 60% e buxhetit janë investime kapitale. I përmendi dy probleme kryesore duke kërkuar edhe përkrahjen e komisionit: 1. Staf i KPM-së nuk e ka tretmanin e shërbyesve civilë edhe pse ata janë, mirëpo nuk përfshihen rritjet e pagave të premtuara nga Kryeministri për këtë kategori; 2. Honorarit e Bordit të Jashtëm janë diçka qesharake

Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2010

Kryetarja, vlerësoi përgatitjen teknike të raportit dhe se i njëjti përmban të gjitha shënimet për shpenzimet e buxhetit në të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike, dhe buxheti është shpenzuar rreth 97 %.

Ismet Krasniqi, pas prezantimit të shkurtër të raportit të pasqyruar me shkrim, ndër të tjera ceku problemin në ekzekutimin e 100% të investimeve kapitale, si rezultat i anulimit të shumë tenderë, për shkak të operatorëve të përgjegjshëm. Raportit të shpenzimeve iu është bashkangjitur edhe raporti për veprimet e ndërmarra nga rekomandimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, si dhe pasqyra e shpenzimit të ashtuquajtur Peti Cash, ku është zvogëluar mundësia e përdorimit të parave të gatshme.

Naser Osmani, theksoi që te kodi 10100 mjetet për deputetët e Kuvendit për paga dhe mëditje shpenzimet janë 99.99, ndërsa dihet që mandati ka përfunduar në muajin nëntor, dmth që për dy muaj nuk ka pasur shtesa për deputetë. Pyeti pse janë evidentuar këto shifra?

Ismet Krasniqi, sqaroi që në bazë të vendimit të Qeverisë është paraparë, që të gjitha organizatat buxhetore, mjetet e pa shfrytëzuara të kthehen prapa.

Istret Azemi, sqaroi ato mjete i ka marrë Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe i ka ndarë për shujtat e shërbyesve civilë, dmth që buxheti i rishikuar për pagat e deputetëve në krahasim me buxhetin përfundimtar është 300 mijë € minus.

Kryetarja, sqaroi që shpenzimi prej 97 % është në buxhetin bazë, mirëpo duhet që përqindja të nxirret në buxhetin e rishikuar, sepse ai është buxheti i tërësishëm i Kuvendit dhe këto përqindje ndryshojnë.

Hykmete Bajrami, sugjeroi që është dashur të paraqitet si zë i veçantë për ato mjete që i ka marrë Qeveria, sepse kjo nuk është mënyra e duhur që eshët paraqitur në raport.

Kryetarja, sqaroi që raportet e audituara shqyrtohen në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Pasi që raporti përmbush kushtet ligjore të raportimit financiar, kërkoi nga sekretari i Kuvendit, që të bëhet korrigjimi i shpenzimit të buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje në programin për deputetët, para se rekomandimi i Komisionit për miratimin e këtij raporti ti dërgohet Kryesisë së Kuvendit.

Pas diskutimeve dhe kërkesave, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit, që të miratojë Raportin e Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2010, me përmisimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje në programin për deputetët.

5. Të ndryshme

5.1. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi se plani i punës së Komisionit është përgatitur nga stafi mbështetës i Komisionit, në bashkëpunim me kryetaren, ku në përgatitjen e tij është marrë parasysh strategjia legislative për vitin 2011 dhe raporti i progresit të Komisionit Evropian, përkatësisht detyrat që dalin për Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ka mbetur të caktohen vendet për dy vizitat studimore që do të realizohen me mbështetjen e GIZ.

Muhamet Mustafa, komplimentojë për mënyrën e përgatitjes së draft-planit vjetor, në veçanti për përfshirjen e detyrave që dalin nga raporti i progresit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve për plotësimin e planit të punës, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Miratohet draft-planin i Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2011, me plotësimet e bëra.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ